

Rexhep Ismajli's contribution to the study of early Albanian texts

Abstract: *Rexhep Ismajli's contributions cover several fields of Albanology. For instance the relationship of Albanian language with other Balkan languages, the presence of Latin elements in Albanian, the research related to the language in the proceedings of the "Albanian Council" (1703) and also extensive studies on early Albanian texts by Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani. Early texts in Albanian are widely studied in several publications by Rexhep Ismajli, such as: Poetry of Pjetër Budi (latest edition in Prishtina, 2006) and also the philological and critical study "Gramatika e parë e gjuhës shqipe (The first Grammar of the Albanian language)", published in Prishtina in 1982. These valuable studies complete a wide range of research on early Albanian literature and textual evidences, which rebuild an important period of the written Albanian.*

Kontributet e profesor Rexhep Ismajlit janë orientuar prej vitesh në fusha të rëndësishme të studimit të dijes së albanologjisë. I përfshirë në diskutime shkencore që kanë të bëjnë me historinë e gjuhës shqipe dhe me kulturën e gjuhës letrare në viset tona, i angazhuar në realizimin e manualeve që ndihmojnë në receptimin e nocioneve themelore të gjuhësisë së përgjithshme në studimet universitare dhe pasuniversitare¹, i përfshirë në gjurmime e arritje kontributesh konkrete në studimet ballkanologjike dhe më tej,² personaliteti i këtij studiuesi të vyer të letrave shqipe plotësohet natyrshëm dhe nga gjurmime të thelluara mbi autorët dhe veprat e letërsisë së vjetër shqipe.

Studimet mbi tekstet e vjetra shqipe dhe mbi dëshmitë më të hershme shkrimore të identitetit tonë kombëtar mbizotërojnë natyrshëm në gjithë panoramën e kontributeve që profesor Rexhep Ismajli i kushtoi albanologjisë dhe studimeve shqiptare.

Çka është me vend të theksohet, veprat e letërsisë së vjetër shqipe shihen me të drejtë në kuadrin e një historie më të gjerë mbi letrat shqipe dhe historinë e shkrimit shqip, fakt që konkretizohet dhe nga trajtesat

1 Saussure Ferdinand(de), *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, përktheu Rexhep Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1977.

2 Shih në veçanti Ismajli R., *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2015.

e vetë Rexhep Ismajlit mbi elemente dhe momente të rëndësishme të kësaj lënde.³ Konsideratat mbi përfshirjen e autorëve të caktuar në këtë panoramë të gjerë të natyrës historike dhe socioletrare Rexhep Ismajli i sqaron me hollësi, duke nënvizuar dhe parametra të domosdoshëm që bëjnë të mundur klasifikimin e veprave që bëhen pjesë e një historie të shkruar të letërsisë shqipe, duke renditur gjithashtu dhe kontribute konkrete që tradita përkatëse e studimeve njeh mbi këto çështje.⁴

Analiza të detajuara tekstesh dhe rrethanash që shoqërojnë përvijimin e këtyre veprave konfirmojnë këtë vizion objektiv mbi një periudhë të rëndësishme të historisë së shkrimit shqip, përfaqësuar nga vepra të veçanta dhe unike në pikëpamje përmbajtjeje dhe ndërtimi.

Gjon Buzuku është një ndër autorët e trajtuar hollësisht në përmbledhjen me titull *Tekste të vjetra*(2000), një ndër veprat që pasqyrojnë gjerësisht një rrugëtim të arsyetuar në fushë të gjurmimit të letërsisë së vjetër shqipe, autorëve dhe teksteve më përfaqësuese të saj.⁵

Në të vërtetë, ndërmarrjet me qëllim sa studimor aq dhe përafrues me veprat e natyrës së *Mesharit* apo të tjera të ngjashme me të në pikëpamje destinacioni bëjnë të vihet në dukje vështirësia në mundësinë e një leximi të rrjedhshëm e të sigurt të teksteve përkatëse.⁶ Dihet që përpjekje jo të pakta janë bërë vazhdimisht në mënyrë që pjesë të caktuara e që përcillnin më mirë natyrën a thelbin e veprave në fjalë të bëheshin të lexueshme e të kuptueshme qoftë me anë përshtatjesh që bënin të mundur dhe afrimin e këtyre teksteve me grafitë e mëvona e që paraqiteshin më të thjeshta, aq dhe me vetë brendinë tekstore që jo rrallë e vë dhe vetë studiuesin para dyshimesh në pikëpamje përzgjedhjeje të zërave që duhen analizuar apo shpjeguar në këndvështrimin semantik e kuptimor. Jo vetëm libri i Gjon Buzukut, por dhe vepra të tjera kryesisht të mëvona nuk shterrojnë lehtësisht nevojën për interpretime qoftë dhe mbi grafitë e pranishme në variantet e shtypura të tyre, qoftë dhe mbi interpretime sinoptike që duhet

3 Sa i takon çështjes së periodizimit të letërsisë së vjetër shqipe dhe konceptit të literalitetit në lidhje me këtë të fundit shih në veçanti Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.46: Përcaktimi i literalitetit të ndryshueshëm në kohë, jo projektimi i konceptimit tonë për literalitetin në ato kohë të shkuara dhe gjurmimi i këtyre vlerave në të kaluarën, do të na bënte të mundur të nxjerrim mbase përfundime paksa të tjera për historinë letrare. Rezultatet nuk mund të parathuhën, por është koha e fundit të shtrohet nevoja për ndërmarrje sistematike.

4 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.9-10.

5 Shih në veçanti dhe Ismajli R., *Les études sur Buzuku aux années '50 du XX-ème siècle*, në *Studia Albanica*, 2006, f.25-36. Në këtë kontribut gjenden të evidentuara dhe të analizuar qartë si kompleksiteti problemor që ngërthen vetë historia e librit të Gjon Buzukut, ashtu dhe tipare të rëndësishme të dy botimeve të plota të tij (përkatësisht në vitin 1958 (N. Ressuli) dhe 1968 (E. Çabej).

6 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.77.

të kenë parasysh më shumë se një vepër.⁷

Në lidhje me *Mesharin* si vepër, pasqyrohen në këtë kapitull kushtuar pikërisht asaj kontributet e Selman Rizës mbi gjuhën dhe veçoritë grafike të paraqitjes së tekstit në këtë libër, gjithashtu dhe interpretimet e thelluara të sjella nga Eqrem Çabej në lidhje me inkonsekuencat në grafi, të pasqyruara që në shkrimet e tij në vitin 1958, për t'u rikonkretizuar dhe në botimin e plotë kritik e filologjik të vitit 1968 të librit të Gjon Buzukut.⁸

Pjesë të zgjedhura nga ky libër pajisen me shënime kritike dhe shpjegime që sqarojnë elemente të kuptimit, përkatësinë dialektore të zërave të veçantë apo dhe raste kur është kryer ndonjë përshtatje në trajta fjalësh të caktuara. Përmendim në këtë rasë tekste himnodike të njohura në liturgjinë e kohës kur u shkrua libri i Buzukut;⁹ variante psalmesh që janë rimarrë në pjesë të ndryshme të librit;¹⁰ Letanitë e Shenjtërve, një tekst që është cituar e ndërmendur vazhdimisht dhe nga gjurmuesit e kontekstit historik që shoqëroi përpilimin e *Mesharit*;¹¹ pasthënia e librit, një tekst përmbyllës që ofron ato pak të dhëna që mund të deduktohen mbi historinë e librit dhe rrethanat e përgatitjes së tij;¹² pjesë nga ungjijtë e në veçanti nga Ungjilli simbas Lukës; variante ungjillore që dhe pse nuk i përkasin librit të Buzukut, japin shkas për përjasje dhe krahasime trajtash apo përftesash të caktuara.¹³ Në të vërtetë, krahasime të mundshme me variante të tjera e kryesisht nga pjesët e ungjijve që përmbahen në librin e Buzukut ofrojnë përherë një pistë studimi tekstor që nënvizon njëkohësisht dhe veçantinë përmbajtësore që mbartin pikërisht këto fragmente nga libri i parë që njohim deri më sot në traditën e studimeve shqiptare.

Një prej realizimeve më domethënëse që përbën njëkohësisht një

7 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.77: Siç theksonte Riza, leximi dhe bartja e teksteve të autorëve të vjetër në alfabetin, për pasojë edhe mundësia e përshtatjes së tyre në gjuhën e sotme, vazhdimisht përbëjnë problem. Përbëjnë problem sepse grafia e atyre autorëve ndryshon nga e sotmja; ndryshon edhe përdorimi normativ i shkronjave dhe i kombinimeve të tyre në të njëjtin tekst; ndryshon mënyra e ndarjes dhe e bashkimit të fjalëve; ndryshon mënyra e përdorimit të shenjave të pikësimit. Përtej të gjitha këtyre ndryshimeve vijnë e shtohen ndryshimet në gjuhën vetë, në mënyrën e shqiptimit, në format gramatikore, në sintaksë, në kuptimet e fjalëve etj.

8 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.79. Po aty, ndërsa trajtohen dhe tipare të shkrimit të Buzuku në gjurmimet e Rizës, të vihet re dhe vërejtja e R.Ismajlit mbi pasqyrën paksa më të ndryshme të leximit të shkrimit të Buzukut nga E.Çabej, realizuar në vitin 1958 dhe pasqyruar në botimin kritik të sipërcituar të vitit 1968.

9 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.85.

10 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.86-87.

11 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.89-91.

12 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.92-93.

13 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.96-97.

ndihmesë të vyer në fushë të studimeve mbi tekstologjinë kritike dhe brendinë e veprave të letërsisë së vjetër shqipe mbetet botimi i pjesëve të përzgjedhura nga krijimtaria dhe përshtatjet e Pjetër Budit, një prej autorëve më të rëndësishëm të kësaj letërsie. Një kontribut i tillë paraqitet në më se një botim, duke qenë pikërisht ai i vitit 2006 një kulmim i natyrshëm në pikëpamje të pasqyrimin të gjithë problematikës që paraqet ndërmarrja e trajtimit dhe interpretimit shumëdimensional të brendisë së veprave të këtij autori.¹⁴

Evidentohen në këtë botim kontributet më të rëndësishme që kanë shërbyer për t'u qartësuar gradualisht një optikë komplekse që ka të bëjë me vetë figurën e personalitetin e Budit e që ngërthen në vetvete përmasa të autorit e shkrimtarit, shqipëruesit e përpiluesit skrupuloz, inovatorit e konservatorit të një tradite shkrimore që mbart qartë elemente të një regjistri aspak të lehtë për t'u lëvruar në shqipe. Vihet në dukje rëndësia e madhe që paraqet disponimi i botimeve sa më të plota të varianteve të veprave që ky i fundit përshtati e përgatiti për botim, gjurmohet në pasazhe të caktuara një pasuri e çmuar e arsenalit leksikor e specialistik që përmbahet në realizimet e këtij autori.

Një aspekt për t'u vlerësuar mbetet evidentimi i një tradite studimore që bëri të mundur të plotësohet gradualisht imazhi mbi një shkrimtar, autor, shqipërues, përpilues dhe përshtatës tekstesh specifike në gjuhën shqipe, pararendës i hartimit të veprave të mëvona që vërtetojnë që të tilla sprova nuk qenë aspak të një vështirësie të vogël qoftë dhe për sjelljen në gjuhën tonë të një korpusi tekstor që ka të bëjë me një tematikë shumë aktuale për kohën në të cilën jetoi ky autor.¹⁵

Radhitja e kontributeve që kanë objekt veprën e Pjetër Budit bën të mundur të pasqyrohen arritje në fushë të studimit të gjuhës së autorit; interpretime të aspekteve të metrikës e të shkrimtarisë së tij; krahasime të mundshme në fushë të realizimit të veprave të ngjashme në areale të afërta; qasje mes gjuhës së autorëve të afërt në kohë me Pjetër Budin; kontekstualizimi i domosdoshëm i vendit që zë vepra e këtij autori në historinë e shkrimit shqip; studime mbi sintaksën e veprave të letërsisë së vjetër shqipe; evidentimi i prurjeve inovative në fushë të leksikut të shqipes; trajtesa të plota në fushë të letërsisë së shkruar dhe të vetë kontributit që përbëjnë realizimet e Budit në fushë të shqipërimit të teksteve biblike dhe atyre liturgjike. Sjellja me qëllim interpretimi e analize

14 Budi P., *Poezi, Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006.

15 Budi P., *Poezi, Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli*, Prishtinë, 2006, f. 12-45. Në këtë ekspozitë të gjerë të Rexhep Ismajlit gjurmohen një sërë aspekteve e trajtesash që hedhin dritë më thellësisht mbi personalitetin, elementet biografike, por dhe shkrimtarinë dhe ndarjet gjinore e tematike në veprën e këtij prelati të letrave shqipe, që jetoi e përpiloi në një kontekst rrethanash aspak të thjeshta në shumë pikëpamje.

tekstore e pjesëve që introdukojnë veprat e Budit rikujton rëndësinë që të tilla tekste paraqesin dhe në ditët e sotme, në pikëpamje të reflektimit mbi rrethanat e botimit të këtyre veprave specifike.

Pjetër Budi mbetet një autor që ka tërhequr për mjaft kohë vëmendjen e studiuesve të teksteve të vjetra shqipe. I përfshirë në pikëpamje kronologjike mes Buzukut dhe autorëve të tjerë si Bardhi e Bogdani, i destinuar të përpilonte e përmbushte një mision të fisëm për kulturën e shkrimit e të tekstit liturgjik në gjuhën shqipe, paraqitet në disa dimensione studimi, ndër të cilat ai i shkrimtarit dhe i shqipëruesit mbizotëron dukshëm. Përftesat gjuhësore dhe mjetet stilistike të këtij autori përbëjnë pa dyshim një objektiv të qëndrueshëm të cilit mjaft studiues të letërsisë së vjetër shqipe i kushtuan shkrime dhe vepra të plota.

Disponimi i disa botimeve dhe ribotimeve të varianteve të veprës së tij, inkoherencat jo të pakëta që vihen re në pikëpamje shtypshkrimi dhe në leximin e fjalëve dhe të grupeve të fjalëve vështirësojnë jo pak dhe punën e filologut që ndërmerr të tejshkruajë, të përafrojë dhe për një publik jo vetëm specialistësh tekstet e kësaj vepre. Një fakt i tillë duhet të ketë kushtëzuar dhe çështjen e realizimit të botimeve kritike e filologjike të këtyre varianteve, veçanërisht nëse bëhet fjale për t'i përfshirë në një vëllim të vetëm që bën të mundur dhe konsultimin sinoptik të tyre.

Në këtë botim të Rexhep Ismajlit pasqyrohet gjithashtu dhe arsenali leksikor i qëmtuar prej Eqrem Çabejt nga vepra e Pjetër Budit.¹⁶ Një evidentim i tillë mbështet sërish shtysën për të kryer gjurmime më të thelluara në gjuhën dhe brendinë e krijimtarisë së këtij të fundit, duke qenë një ndër autorët më të rëndësishëm të një periudhe themelore për shkrimin shqip dhe lëvrimin e letërsisë së shkruar në gjuhën tonë.

Dimensioni i prozatorit do të jetë një ndër linjat tematike mbizotëruese në gjurmimet filologjike të Rexhep Ismajlit mbi këtë autor kaq të rëndësishëm.¹⁷ Rimerret me të drejtë çështja e personalitetit që receptohet

16 Budi P., *Poezi, Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli*, Prishtinë, 2006, *Fjalë që sipas Çabejt dalin për herë të parë te Budi*, f.46-53.

17 Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.132: Prozatorin e parë të letërsisë shqipe, Pjetër Budin, e shquan edhe një tjetër element: tekstet e tij në kontekstin letrar fetar nuk janë manuale të mirëfillta fetare, siç janë në origjinalet e tyre italiane e latine. Në letërsinë romane të Perëndimit, ku gjinitë dhe llojet letrare tashmë ishin degëzuar shumë, tekstet e tilla nuk mund të kishin funksione të tjera jo vetëm pse letërsia laike në vazhden e traditës që nga antika po veçohet gjithnjë e më shumë nga religjioni në kuptimin e ngushtë të fjalës, po edhe për shkak se edhe në kuadër të letërsisë së mirëfilltë fetare degëzimi i gjinive dhe i llojeve e kishte bërë të vetën. Në letërsinë shqiptare, ku gjithçka detyrimisht shkruhet në të njëjtin libër, ku edhe libri fetar kontrollohet në detaje nga censorët, ku shkrimi i librit ende ishte akt shumë i rrallë intelektual, mbase dhe jo shumë joshës për shkak se nevojtar dhe problemet e lexuesit të mundshëm (shumë të paktë) i takonin fushës së kulturës së aksionit, ku shkrimi që më parë cilësohej si akt armiqësie, ku çdo gjë që i ngjante lëvizjes intelektuale duhej

ndjeshëm nga pjesë dhe elemente tekstore që mbështesin natyrshëm gjithë shtrirjen tematike të përpilimeve të Pjetër Budit, bashkë me faktin që në pikëpamje vëllimi e përmbajtjeje është më se e qartë që nuk ka përkime të plota me variantet të cilave ky i fundit duhej të kishte pasur modele referimi, duke qenë vetë destinacioni fillestar i sprovave të tij të shqipëronite e të përshtaste në gjuhën amtare.¹⁸

Studimi në pikëpamje filologjike i përmbajtjes së veprës së Pjetër Bogdanit zë një vend të konsiderueshëm në gjurmimet kryesisht tekstologjike të Rexhep Ismajlit. Kontributet në lidhje me këtë autor kanë shënuar arritje të lavdërueshme në dekadat e fundit, duke u konkretizuar dhe në botime të natyrës anastatike shoqëruar me shënime përkatëse, apo dhe të natyrës filologjike-kritike që mëtojnë të përafrojnë sa më shumë studiuesin me brendinë e kësaj vepre.¹⁹

Të një interesi të veçantë paraqiten vëzhgimet e këtij studiuesi në lidhje me gjuhën, veprën dhe vendin e Pjetër Bogdanit në letërsinë e shkruar shqipe, duke u konsideruar me të drejtë nga një këndvështrim i duhur, që lejon të bëhen dhe dallime përkatëse me autorë paraardhës, që në raste të caktuara dhe mund të jenë përqasur e krahasuar me Bogdanin.²⁰

Në lidhje me çështje themelore të studimit të gjuhës së këtij autori, nuk mungojnë në shënimet e Rexhep Ismajlit vërejtje kritike mbi leximin e tekstit dhe të elementeve themelore në të, siç është dhe nyja, një argument që për një kohë të gjatë ka tërhequr me të drejtë dhe interesin e vëmendjen studimore të gjurmuesve të historisë së gjuhës së shkruar dhe të vetë shkrimit shqip. Evidentime të natyrës leksikore dhe semantike nga ana e Rizës dhe e Sciambras bëhen pjesë e trajtesës mbi Bogdanin. Siç dhe dihet, në këndvështrimin e Sciambras janë përfshirë dukshëm përftesa dhe elemente të rëndësishme leksikore nga tekstet e Bogdanit, duke u klasifikuar dhe në pikëpamje të përkatësisë në regjistra specifike gjuhësorë.²¹ Në vështrimin

të bëhej në ilegalitet të thellë, në këtë letërsi, ku nuk mund të kishte asfarë diferencimi zhanror, secili tekst detyrimisht merrte funksion letrar.

18 Shih edhe Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.131: Në tekste dhe studime me karakter historiko-letrar është vënë në dukje sse në këto vepra ka shumë fragmente origjinale që nuk janë tek autorët burimorë, si dhe se ato përbëjnë rreth 100 faqe parathënie, pasthënie e letra baritore proze të mirëfilltë origjinale. Në këto 100 faqe gjithësi del qartë në mënyrë të bollshme talenti, figura dhe personaliteti i shkrimtarit, stili dhe qëndrimi i tij, pjesërisht edhe ideologjia. Kjo e fundit del në mënyrë shumë të qartë në relacionet që Budi i dërgonte në Vatikan, sidomos në letrën që ia kishte dërguar Kardinal Gozzadino-s, e cila e tregon në një dritë tjetër-në dritën e luftëtarit të Patries, gjë që nga shkrimet fetare mund të nxirret vetëm ndërmjetshëm.

19 Shih dhe Bogdani P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*, botim kritik përgatitur nga A.Omari, Tiranë, 2005.

20 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, Pejë, 2000, f.307.

21 Sciambra M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua)*, volume II, *saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Pàtron editore, Bologna, 1965.

e kujdesshëm të Rexhep Ismajlit mbi trajtesat e Sciambbras do të gjinden të veçuara pjesë të caktuara të ligjëratës, të dallueshme dhe në pikëpamje të mjeteve të veçanta të formimit që evokojnë modele formimi në shqipen e kohës, fjalë që vijojnë të bartin dhe sot e kësaj dite një ngarkesë të veçantë në pikëpamje kuptimore dhe dialektore, veçanërisht nëse jetojnë akoma në të folme të shqipes.²²

Një vlerë më vete në trajtimin kompleks mbi veprën dhe personalitetin e Bogdanit merr përzgjedhja tekstore që bën të jenë të veçuara për arsye studimi një sërë pjesësh nga *Cuneus Prophetarum*(1685). Pajisen me shënime kryesisht shpjeguese pjesë si *Të Primitë përpara letërarit; Përmbi t'Ardhunit e Mesisë Krishtit shëlbuesit shekullit*(*Ligjërata I: Qish don me thanë profecia*); *Të pagëzuemitë e Jezu Krishtit, njinesset e tendimit së tijnaj ndër shkretët*(*Scala I, Ligjërata VIII*);²³*Si e krijoi Zotynë Adamnë et Evënë, të parët tanë print*(*Scala I, Ligjërata VI*);²⁴*Jeta e dhjete sibilavet e kankete tyne*;²⁵*Si e krijoi Zotynë qiellnë*(*Scala I, Ligjërata IV*);²⁶*Si është ndër tre vetëm nja i vetëmi Hyj*(*Scala I, Ligjërata II*);²⁷*Si është Hyji ndër vetëhe*(*Scala I, Ligjërata I*);²⁸*Jeta e Davidit Profetë*(*Scala III, Ligjërata II*);²⁹*Jeta e Salomonit Profetë e profecite tinaj*(*Scala III, Ligjërata IV,116*);³⁰*Cihariqi i Engjëllit së lumesë Virgjne Mri*(*Scala I, Ligjërata III, 16*);³¹*Të lemit e Jezu Krishtit, Zotit tinë*(*Scala I, Ligjërata IV*);³²*Të adhëruemit e tre regjnjet*(*Scala I, Ligjërata VI, 31*);³³*Mrekullit e Jezu Krishtit Zotit tinë. Si e kthei Jezu Krishti ujëtë ndër venë ndër Kana Galilet*(*Scala II, Ligjërata I, 46*);*Pleqënia e shtëpisë Bogdananjet etj. Përfshihen në këtë nënndarje të veprës Tekste të vjetra të R.Ismajlit dhe*

22 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.309: M.Sciambra kishte bërë një studim gjithsesi me interes për leksikun kulturor të Pjetër Bogdanit dhe kishte parashikuar të tjerë që nuk dolën më vonë. Me atë rast ai ishte marrë kryesisht me çështje leksikore të gjuhës së Bogdanit, të para dhe nga aspekti i stilit. Duke folur për idiomatizmat e Bogdanit, ai kishte përmendur shprehjet vijuese *desh u dënue, dita e gjyqit, dita e të Shëlbuemit, mjerë, për nderë të Krishtit*. “Ajo që është më kurioze është fakti se disa herë teksti paralel italian është ndikuar nga idiomatizmi shqiptar (çka na pohon se nëse Bogdani mendonte me terma shkencorë tradicionalë, tekstin e kishte hartuar shqip dhe përkthyer italisht)”.

23 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.337-340.

24 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f. 341-342.

25 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.343-359.

26 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.360-368.

27 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.369-370.

28 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.371-372.

29 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.373.

30 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.374.

31 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.375.

32 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.376.

33 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.377.

pjesë që në të vërtetë përbëjnë veçanti në ndërtimin e veprës së Bogdanit e që kanë të bëjnë me përpilime të natyrës dedikatore a kushtuese e që e afrojnë vetë këtë vepër me modele tekstore të kohës në të cilën jetoi ky autor i letrave shqipe.³⁴

Zënë të tilla trajtesa një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së veprës *Tekste të vjetra*, duke qenë vetë Bogdani një prej autorëve më kompleksë të letërsisë së vjetër shqipe, me tipare shkrimtarie që nënvizojnë unicitetin dhe kthjelltësinë e tij në të shkruar e në përpilimin e ligjëratave që e ndërtojnë veprën e tij.³⁵

Një kontribut i qenësishëm që dëshmon vijimësinë në pikëpamje të gjurmimit të dëshmive shkrimore më të hershme në gjuhën tonë mbetet dhe botimi me titull *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, botuar në Prishtinë në vitin 1982. Në këtë vepër që është përpiluar nën synimin e qartë për të plotësuar një panoramë botimesh dhe sprovash mbi dokumente e dëshmi shkrimore mbi gjuhën tonë dhe aspekte gramatikore të studimit të saj mbizotëron një orientim i qartë që ka të bëjë me sqarimin e mjaft linjave: rëndësia e studimit të dorëshkrimit që bëhet objekt studimi dhe kontekstualizimi kronologjik i saj dhe në raport me të tjera vepra e realizime që hedhin dritë gjithashtu mbi historinë e shkrimit shqip dhe të letërsisë së shkruar shqipe; specifika përmbajtësore e këtij dorëshkrimi dhe veçanti grafike që bëjnë të mundur qasje në të njëjtën pikëpamje me vepra në të cilat vihen re shenja grafike e elemente të ngjashme; nënvizimi i rëndësisë që paraqet disponimi i burimeve të tilla, gjithnjë duke qenë më se e qartë se dhe studimi i tyre përbën vlera të shtuara në gjithë historikun e gjurmimeve mbi tekstet e vjetra dhe përmbajtjen e tyre.³⁶

Përbën një korpus i tillë gjurmimesh të R. Ismajlit kryesisht mbi autorët e letërsisë së vjetër shqipe një rikonfirmim të një metodologjie studimi që përqendrohet në autorë dhe tekste, duke nënvizuar sërish rëndësinë e vëzhgimit tekstologjik të përmbajtjes së veprave të kësaj letërsie.³⁷ Autorë si Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani kontribuan në

34 Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.385-389.

35 Shih dhe kapitullin me titull *Fjalësi i Bogdanit* në Ismajli R., *Tekste të vjetra, botim i cituar*, Dukagjini, 2000, f.406-414. Një syth më vetë në veprën e sipërcituar *Tekste të vjetra* i kushtohet dhe Frang Bardhit, autorit të Dicionarit latinisht-shqip të vitit 1635, fjalësi i të cilit pasqyrohet gjithashtu në një nënndarje të veçantë të kësaj vepre, përkatësisht në f.398-405.

36 Ismajli R., *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f.5: Tekstet e vjetra të gjuhës shqipe janë mjaft të pakta në numër, nganjëherë madje mezi të mjaftueshme për të rindërtuar një gjendje gjuhe. Mungojnë sidomos burimet dorëshkrimore, ndërsa libri i parë i shtypur na del mjaft vonë- më 1555. Proporcionalisht me seriozitetin e kësaj mungese vjen e rritet edhe vlera e secilit burim të ri, sepse informacioni është më i madh.

37 Shih gjithashtu Ismajli R., *Gjuha shqipe e "Kuvendit të Arbënit"*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

mënyrë decizive në përvijimin e një tradite shkrimore që lidhet pikërisht me një nga periudhat më të rëndësishme të letërsisë së shkruar shqipe, specifika e së cilës vihet në dukje pikërisht nga studimi i tekstor dhe nënvizimi i linjave tematike që i përshkojnë të tilla tekste.³⁸

Bibliografi

- Ashta K., *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, në *Studime filologjike*, n.4, 1966.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Shkodër, 1996.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1998.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Tiranë, 2000.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe V*, Shkodër, 2009.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe VI*, Shkodër, 2012.
- Bogdani P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*, botim kritik përgatitur nga A.Omari, Tiranë, 2005.
- Borgia N., *Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV (da un Manoscritto Greco della Biblioteca Ambrosiana)*, Scuola Tipografica Italo-Orientale « San Nilo », Grottaferrata, 1930.
- Budi P., *Rituale Romanum et Speculum confessionis in Epyroticam linguam a Petro Budi Episcopo Sapatense et Sardanense translata*, Romae, 1621.
- Budi P., *Dottrina Christiana, composta per ordine della fel.mem. di Papa Clemente VIII*, Roma, 1664.
- Budi P., *Dottrina Christiana(1618), with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane*, Institut for Lingvistik, Aarhus, 1985.
- Budi P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Bulo J., *Le « Missel » de Gjon Buzuku entre la Reforme et la Contre-Reforme*, në *Studia Albanica*, 2006.
- Camaj M., *Për vokalin nazal ke Buzuku (La vocale nasale in Buzuku)*, Estratto dalla Rivista *Shêjzat (Le Pleiadi)*, n.5-6, 1959.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shêjzat*, Romë, 1960.

38 Siç dhe parashtrohet hershëm në qasjet e natyrës introduktuese që studiuesi Ismajli shtjellon në sqarimin e objektit të studimit në lidhje me këta autorë, veçanërisht me autorët e shekullit të shtatëmbëdhjetë, kontekstualizimi i periudhës së cilës dhe i përkasin veprat e këtyre autorëve i shërben konkretisht çështjes së periodizimit të letërsisë së shkruar shqipe.

- Camaj M., *Pjetër Budi*(në rasën e katërqindvjetorit të lindjes), në *Shêjzat*, n.9-12, 1966.
- Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BUSHT*, n.2, 1959.
- Çabej E., *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, në *Studime filologjike*, n.4, 1966.
- Çabej E., *Vepra e Gjon Buzukut në vështrim historik e gjuhësor*, në *Studime filologjike*, n.1, 1979.
- Çabej E., *Shqipja në kapërcyell: Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Demiraj B., *Viti i zbulimit të Mesharit të Gjon Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në *Biblos*, Palermo, 2003.
- Ismajli R., *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, në *Gjurmime Albanologjike*, Prishtinë, 1978.
- Ismajli R., *Disa çështje të onomastikës shqiptare të mesjetës*, në *Studime filologjike*, n.4, 1978.
- Ismajli R., *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, në *Studime filologjike*, n.4, 1980.
- Ismajli R., *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1982.
- Ismajli R., *Gjuha shqipe e "Kuvendit të Arbënit"*, Rilindja, Prishtinë, 1985.
- Ismajli R., *Pjetër Budi*(Poezi), Prishtinë, 1986.
- Ismajli R., *Artikuj për gjuhën shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1987.
- Ismajli R., *Kontributi i Martin Camajt në studimet buzukiane*, në *"Meshari" i Gjon Buzukut-monument i kulturës shqiptare (1555-1995)*, Ulqin, 1995.
- Ismajli R., *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, në *Studime 3*, Prishtinë, 1996.
- Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, Pejë, 2000.
- Ismajli R., *Studime për Buzukun në vitet '50 të shekullit XX*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2005.
- Ismajli R., *Les études sur Buzuku aux années '50 du XX-ème siècle*, në *Studia Albanica*, 2006.
- Ismajli R., *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- Ismajli R., *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2009.
- Ismajli R., *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2015.
- Lacaj H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, në *Studime filologjike*, n.4, 1966.
- Marlekaj L., *Doli libri më i vjetri i gjuhës shqipe*, në *Shêjzat*, nr. 1-2, 1959.
- Marlekaj L., O.F.M., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.

- Omari A., *Disa risi në fushën e botimit të teksteve të vjetra shqipe*, në Konferenca shkencore: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, ASHAK, 2009.
- Omari A., *Veçori të punës filologjike të Selman Rizës me tekstet e vjetra shqipe*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2010.
- Paci E., *Meshari i Gjon Buzukut në studimet e Martin Camajt*, në *Hylli i Dritës*, n.4, 2010.
- Paci E., *Çështje të sistemit mbiemëror në Fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit(1635)*, në *Filologji*, Prishtinë, 2010.
- Paci E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2011.
- Paci E., *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2012.
- Paci E., *Çështje të leksikut liturgjik në veprën e Pjetër Bogdanit*, në *Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes*, Botime Koha, Prishtinë, 2012.
- Ressuli N., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
- Ressuli N., *I più antichi testi albanesi*, G. Giappichelli, Torino, 1978.
- Ressuli N., *Shkrimtarët shqiptarë I, (1462- 1878), Botim II*, Pakti, Tiranë, 2007.
- Riza S., *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1961.
- Riza S., *Vehtësia dhe veprat e Pjetër Budit*, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e Shkencave filologjike, VIII, Prishtinë, 1978.
- Riza S., *Vepra I*, ASHAK, Prishtinë, 1996.
- Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002.
- Riza S., *Vepra IV*, ASHAK, Prishtinë, 2004.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- Sciambra M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua), volume II, saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Pàtron editore, Bologna, 1965.
- Sedaj E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe*, Shtufi, Prishtinë, 1999.
- Sedaj E., *Shqipja arbërore*, Prishtinë, 2002.
- Svane G., *How to read Budi's Speculum confessionis*, në *Studia Albanica*, n.1, 1980.
- Svane G., *The formation of the literary language as reflected in Budi's « Mirror of Confession » 1621*, në *Studia Albanica*, n.2, 1985.
- Svane G., *Formimi i gjuhës letrare të « Speculum Confessionis » e Budit*, në *Studime filologjike*, n.2, 1986.
- Zamputi I., *Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n.3, 1954.
- Zamputi I., *Ricerche su Pjetër Bogdani*, në *"Rassegna di studi albanesi"*, Roma, n.1, 1964.

- Zamputi I., *Koha dhe veprimtaria e Pjetër Budit*, në *Nëndori*, n.9, 1966.
- Zamputi I., *Qëmtime për Budin e Bardhin*, në *Studime historike*, n.1, 1985.
- Zamputi I., *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike* n.3, 1986.
- Zamputi I., *Les circonstances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në *Studia Albanica*, n.1, 1988.
- Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.